

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

2019

03-09

Nj. Crg.	Numeri	Shifra
01	060	48962

Komuna / Opština: Drenas **Data / Datum:** 29.08.2019

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 5

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒ **Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak** ☐

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 13

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☐

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☒ *Shqipe Zogu, drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, Burim Jonuzi zyrtar i Komisionit Komunal për Zgjedhje dhe KFOR-i..*

Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë
Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo Nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 15.07.2019;
2. Përgatitjet nga DKA dhe Stacioni Policor për parandalim të dukurive negative për vitin akademik 2019/2020;
3. Raportim për aktivitetet gjatë "Muajit të Mërgatës";
4. Të ndryshme (Zgjedhjet e jashtëzakonshme).

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Mbledhjen e kryesoi fillimisht nënkryetari Nazmi Hasi e më pastaj kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.

1. Pika e parë e procesverbalit nga mbledhja e kaluar ka kaluar pa ndryshime.
2. Për pikën e dytë raportuan Policia dhe Drejtori i Arsimit për përgatitjet e kryera. Florim Geci përfaqësues nga Policia në Drenas, njoftoi se tashmë ka plan konkret për sigurinë në shkolla dhe në komunikacion pranë shkollave ku rrugët regjionale kalojnë në afërsi të objekteve shkollore si në Drenas, në Zabel të Ulët dhe në Tërstenik e ku do të bëhen pika kontrolli. Ndërsa drejtori i DKA-së, Tafil Halilaj ka treguar se DKA ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkolle e gjithashtu kanë pasur takim edhe me Asociacionin e Komunave për të parandaluar dukuritë negative.
Nënkryetari i Komunës, Nazmi Hasi ka kërkuar bashkëpunim mes Stacionit Policor në Drenas dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit si dhe me drejtorët e shkollave për të ruajtur sigurinë publike në institucionet arsimore.
Ndër të tjera për këtë pikë u dhanë ide se si të mundësohet identifikimi me ndonjë veshje apo aksesori dallues trafik i nxënësve që për herë të parë fillojnë mësimin këtë vit, harmonizimi i orarit të autobusëve, parandalimi i qasjes në objekte shkollore të jo nxënësve përmes bizneseve që operojnë brenda objekteve shkollore si dhe mundësitë për mbajtjen e ligjëratave me synim parandalimin e dukurive negative.
3. Në pikën për raportimin mbi “Muajin e Mërgatës”, ka raportuar drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Shqipe Zogu, e cila ka treguar detajet e shënimit të këtij eventi i cili tanimë është bërë tradicional, i pasur me aktivitete të shumëllojshme. Sipas drejtoreshës Zogu, bashkëpunimi me Policinë dhe organizatorët ka qenë i kënaqshëm dhe nuk ka pasur ndonjë incident të raportuar në DKRS.
4. Në pikën të ndryshme u diskutua për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Burim Jonuzi, zyrtar i KKZ-së raportoi për përgatitjet dhe tha se janë marrë të gjitha masat që procesi të shkojë mirë. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka kërkuar nga Komisioni Komunal Zgjedhor, Stacioni Policor në Drenas dhe nga të gjithë akteret tjerë që të ndërmarrin masat me kohë për mos pasur probleme të natyrës që dëmtojnë procesin e zgjedhjeve dhe sigurisë publike, siç ka ndodhur në zgjedhjet e fundit lokale dhe Policia nuk i ka marr masat e duhura për rastet e raportuara.

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci

nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 03.09.2019

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.